



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC**

Numri i lëndës: 2023:066202

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05846558

CN.nr.19/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, në çështjen jokontestimore të propozuesit S (K) H nga Rahoveci, lidhur me propozimin për ndarjen e pasurisë së palujtshme, jashtë seance, me datë 21.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

KONSIDEROHET SË ËSHTË TËRHEQUR propozimi i propozuesit S (K) H nga Rahoveci, lidhur me propozimin për ndarjen e pasurisë së palujtshme.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Propozuesi S (K) H nga Rahoveci, me datë 14.03.2023 ka paraqitur në Gjykatë propozimin për ndarjen e pasurisë së palujtshme.

Gjykata ka caktuar seancës përgatitore me datë 19.06.2024, në shkresat e lëndës ekziston prova – fletëkthesa se propozuesi është ftuar në mënyrë të rregullt, mirëpo i njëjti në seancën përgatitore nuk ka ardhur dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, po ashtu për kundërpropozuesit nuk ka prezentuar askush, për të cilët ka prova se janë ftuar në mënyrë të rregullt mirëpo mungesën nuk e kanë arsyetuar.

Duke marrë parasysh faktin se palët në seancë përgatitore nuk kanë prezantuar, gjykata vendosi si në dispozitiv, e në pajtim me dispozitat e nenit 12 pika 3 të LIGJI Nr. 03/L-007 Për Procedurën Jokontestimore, në të cilin nen thuhet se: *“Konsiderohet se propozuesi e ka tërhequr propozimin po qe se nuk vjen në seancën e parë për të cilën është thirrur në mënyrë të rregullt. Kjo rregull nuk vlen në qoftë se ekzistojnë shkaqe të ditura botërisht të cilat e kanë penguar propozuesin që të vijë në seancë”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, që secila palë t’i bartë këto shpenzime, është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në bazë të nenit 12 pika 3 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
CN.nr.19/2023, më datën 21.06.2024

Bashkëpunëtorja profesionale  
Shpresa Haxhijaha Rahmani

Gjyqtari  
Avni Berisha

**KËSHILLË JURDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.